DHE DRIT' E DITURISË PËRPARA DO NA SHPJERË. N. Frashëri

E PERJAVESHME LETRARE-ARTISTIKE

# DRITA

VITI III Nr. 5 (110)
3 SHKURT 1963

ORGAN I LIDHJES SE SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISE

Çmimi lekë 5

VEHBI SKENDERI

## RINI, RINI!

*Rini, rini!*
*Sa male e maja ngjitëm*
*Dhe sa lumenj kaluam në shtrëngatë!*
*Të qetë, nën një shkëmb, mëngjezin pritëm*
*Duke përtypur, t'urët, një kafshatë.*

*Rini, rini!*
*S'u dehm' e s'u përkuntmë në vallzim*
*Dhe s'gjuajtëm këpucë mode e bluza.*
*Na kripi djersa qafën në marshim*
*E na u poq në luft' prej etjes, buza.*

*Rini, rini!*
*Ne dashurinë e kyçnim*
*Si ç'fsheh ky dhe në gjin e vet thesarët.*
*Dhe mijëra prej nesh këtë roman e mbyllnë*
*Pa shkruar dot*
*Rrjeshtin e tij të parë.*

*Rini, rini!*
*Endërronim neve shumë*
*Mbi një kërcu gjith natën duke gdhirë.*
*Po shpesh në mes i korrte ëndrrat plumbi,*
*Që s'priste as t'ju thoshnim: Lamtumirë:*

*Rini, rini!*
*Burbuqet tona ngelën*
*Ndër telat gjithë ndryshk, në shkrepa e në gurë.*
*Po s'plakemi ne jo! Ne portat e komunes çelëm*
*Për këtë popull trim,*
*Që pleqëri s'njeh kurrë!*

## KJO RRUGE...

*Kjo është rruga më e re sot në qytet,*
*Nuk janë hequr skelat nga shtëpitë;*
*Të shkel papritur këmba në një pellk*
*Dhe të mërzitin*

*Sikur ja shton stolinë.*
*Unë e shikoj... më ngjan si një postaf*
*Ku krahë - shpejtët vite,*
*Kalimthi, ujë pinë.*

*Kjo rrugë hyn mes kohës shumë largë,*
*Si një arter i gjelbërt nëpër trup.*
*Mjerimi kurrë nëpër 'të s'do çapet*
*Me torbën e kotherevе*
*Mbi sup!*

## NUK ISHE TI

*Unë drejt teje sot vrapoj me «Ekpres».*
*Ja si kërcasin*
*Nëpër shina rrotat.*
*Po pse më ngjan sikur s'lot fare bota.*
*Me mallin tim*
*Përse më vjen se qesh?*

*Sa një kuvli më duket kjo kabina.*
*Kur ja diçka*
*Më fëshfërit ngadalë.*
*Mos leshrat ti m'i shpupuris në ballë?*
*Oh, nuk je ti,*
*Po flladi nga lëndinat.*

*Treni vrapon. Që larg vrej një xhami*
*Dhe një stacion*
*Rrethuar me ullinj.*
*Dikush me gisht në xham më trokëllin!*
*Po nuk je ti e dashur,*
*Bije shi.*

## DHURATE PER DITLINDJEN

*Ti m'i dhuron posi petalje përkëdheljet*
*Katërvjeçarja ime:*
*Dhe unë yt' atë,*
*Në vënd të kukllës mjaft të shtrenjtë,*
*Për ditë-lindje*

## TEATRI I FEMIJEVE DHE I TE RINJVE

Më datë 31 janar të këtij viti filloi aktivitetin e tij Teatri i fëmijëve dhe i të rijve. Me këtë rast u dha premiera e eposit dramatik «Gjergj Elez Alija», simbas poemës popullore, shkruar dhe vënë në skenë nga regjizori Selman Vaqari. Në çfaqje asistonin antarët e Byrosë politike të Komitetit Qëndror të P.P.SH. shokët Rita Marko e Spiro Koleka, zëvëndës ministri i arsimit e kulturës shoku Thoma Deljana, sekretarja e Komitetit Qëndror të Rinisë shoqja Jorgjia Premti, punonjës t'artit e të kulturës dhe spektatorë të rij. Përpara fillimit të çfaqjes të pranishmëve u foli udhëheqësi artistik i këtij teatri, shkrimtari dhe regjizori Selman Vaqari. Ai theksoi ndër të tjera:

«Për rëndësinë e një teatri fëmijësh dhe të rijsh, ku brezi ynë i ri të shohë të inskenueme pjesë të njohuna të letërsisë sonë e të letërsisë botërore, ku të gjejë vehten në dramë e komedi të luftës e të punës asht folë vazhdimisht. Kjo nevojë po plotësohet sonte me çfaqjen tonë të parë.

Na kemi ndërmënd që këtë lokal të bukur tonin ta bajmë një qendër të edukimit estetik dhe etik të rinisë me çfaqje kukllash, pjesë teatrale dramatike, numura estrade etj. Vështirësitë e kësaj pune janë të kjarta kur të mendohet se aktorët tanë luejnë në skenë për herë të parë e natyrisht do të kenë edhe të meta. Por na kemi besim se ky kolektiv do të ecë përpara edhe në këtë gjini skene».

Pastaj u dha çfaqja «Gjergj Elez Alija» e cila është pregatitur për t'u ardhur në ndihmë nxënësve, studentëve dhe pedagogëve për lëndën e gjuhës dhe të letërsisë. Interpretuan aktorët Sami Jahja, Liri Dhimitri, Xhavit Sallaku, Pleurat Armiri, Zija Grapshi, Zihni Begaj, Ibrahim Braho, Xhavit Xhepa etj. Skena e piktorit Tonin Shiroka qe e goditur dhe e bukur.

Duke përshëndetur këtë hap të parë, gazeta «Drita» i uron Teatrit të fëmijëve dhe të rijve suksese të vazhdueshëm në misjonin e tij fisnik për edukimin komunist të fëmijëve dhe brezit tonë të ri.

Korespondenti i gazetës «Drita»



Sami Jahja në rolin e Gjergj Elez Alisë dhe Liri Dhimitri në rolin e së motrës.

## Rrethi letrar i Korçës

Viti që kaloi ka qënë mjaft i frytshëm në krijimin e letrarëve korçarë. Në mbledhjen e fundit të rrethit letrar, drejtori i pallatit të kulturës sh. Vangjo Vangjeli tha se numa të ndryshme interesante si p.sh. vëllimi me poezi «Lirikat e majit» i Koçi Petritit, i cili së shpejti del edhe në qarkullim, përmbledhur nga Vangjush Ziko, etj. Një ndih p.sh. «Mbi mjeshtërinë e shkrimtarit» pu